

"Ne ju ofrojmë ndihmë në rrugën drejt BE-së"

Ideja e bashkimit paqësor të Evropës kurrë nuk ka qenë diçka që është dashtë të merret si e mirëqenë. Në shikim të parë mund të duket shumë e qartë; megjithatë, gjithmonë ka pasur shumë pengesa në rrugë. Por sot, me përfshirjen e shteteve të Ballkanit Perëndimor në procesin e bashkimit, fundi i kësaj rruge të gjatë është më afër se kurrë më parë. Raportet e Komisionit Evropian tregojnë që, prej vitit në vit, shtetet tuaja po i afrohen gjithnjë e më afër anëtarësimit në BE. Ky është lajm i mirë. Gjersa e shikojmë hartën, është e qartë që pa juve Evropa nuk është e plotë. Njeriu kurrë nuk mund ta kuptojë historinë evropiane pa e njohur historinë e pasur të rajonit tuaj.

Bashkimi Evropian ishte themeluar si projekt i paqes dhe ia ka dalë mbanë në këtë ambicie. Sidoqoftë, përtej kufijve të Unionit historia vazhdoi të ecë në rrjedhën e saj. Por edhe ju e meritoni jetën në paqe, stabilitet dhe siguri të cilën e simbolizon Unioni. BE është më shumë se sa një grup i shteteve të cilat punojnë së bashku për çështjet e interesit të përbashkët; është një bashkësi e shteteve dhe e qytetarëve të cilët kanë vendosur ta ndajnë fatin e tyre së bashku dhe të përballen me të ardhmen së bashku.

Bashkimi i Evropës nuk ka të bëjë vetëm me shndërrimin e një ideali në realitet. Ai ofron përfitime të prekshme politike, ekonomike dhe të sigurisë duke u bazuar në solidaritetin dhe në kohezionin e anëtarëve të Unionit. Zona e paqes, stabilitetit dhe prosperitetit nuk është koncept i zbrazët; është program real për projektin evropian dhe sfidat e jashtme me të cilat po përballlet Evropa dhe krizat aktuale të migrimit e konfirmojnë këtë në veçanti. Ato po ashtu e tregojnë domosdoshmërinë e të qenit në gjendje të ofrojmë përgjigje më efikase dhe më koherente. Rëndësia e shteteve të Ballkanit Perëndimor për Unionin në këtë kontekst është vendimtare meqë rajoni juaj gjeografikisht – edhe pse ende jo politikisht – është brenda Bashkimit Evropian. Ne e çmojmë rolin pozitiv dhe përkushtimin e vendeve të cilat janë prekur nga kriza e refugjatëve, të cilën krizë nuk e kanë shkaktuar ato vetë.

Ashtu siç kemi premtuar në Selanik vite më parë, dera e Unionit është e hapur për juve dhe kjo nuk do të ndryshojë. Shpejtësia e procesit të anëtarësimit varet nga përmbushja juaj individuale. Ne dëshirojmë që të gjitha shtetet që janë në proces të zgjerimit të maten me kutin e njëjtë dhe, prandaj, ne do të jemi gjithmonë kundër vendosjes së kushteve apo të përpjekjeve shtesë për ta ngadalësuar

procesin tuaj të anëtarësimit. Por në anën tjetër kjo do të thotë që rregullat sipas të cilave drejtohet zgjerimi nuk duhet të zbuten. Në mënyrë që t'i bashkoheni Unionit duhet të bëhen reforma të nevojshme në fushën e sundimit të ligjit, të të drejtave themelore dhe të qeverisjes ekonomike –edhe për neve ka qenë kështu, ashtu siç është për juve sot. Vlerat e përbashkëta të lirisë, të demokracisë dhe të të drejtave të njeriut mbesin vendimtare. Të dy palët e kanë për detyrë të sigurojnë që procesi i anëtarësimit mbetet i besueshëm, të bashkëpunojnë dhe të kërkojnë qasje të përbashkëta.

Përparimi të cilin e keni arritur deri më tani në krijimin e raporteve të mira fqinjësore është për t'u admiruar. Këto raporte nuk do ta humbin aspak rëndësinë e tyre madje edhe pasi që të anëtarësoheni në Bashkimin Evropian. Fqinjësia e mirë është themel i çdo komuniteti. Kjo vlen edhe për Evropën Qendrore: të katër shtetet tona të Grupit të Vishegradit – Republika Çeke, Hungaria, Polonia dhe Sllovakia – nuk janë të bashkuara nga gjuha e përbashkët, por ne e ndajmë një përvojë të përbashkët historike të gjysmës së dytë të shekullit 20 dhe e dimë që ka kuptim të bashkëpunosh.

Vendet tona gjenden në fqinjësi të afërt me rajonin e Ballkanit Perëndimor. Për këtë arsye ne e përcjellim nga afër përparimin tuaj në rrugën drejt familjes evropiane duke pasur bindje të madhe që kjo është në interesin më të mirë si të Ballkanit Perëndimor ashtu edhe të BE-së. Për t'u përgatitur për anëtarësim nevojitet kohë. Edhe shteteve tona u janë dashur vite të tëra për t'u bërë anëtare të plota. Megjithatë, kjo nuk ishte humbje e kohës kot. Vitet ishin të mbushura plot me punë të rëndësishme dhe shumë të nevojshme. Duke ju falënderuar kësaj përvoje, ne e kuptojmë rëndësinë e mbështetjes nga shtetet që tashmë janë bërë pjesë e Unionit. Ne ju ofrojmë ndihmë dhe përvojën tonë në këtë rrugë e cila është ende para jush, por gjithmonë varet nga ju që ta bëni hapin e parë. Me kënaqësi ju sigurojmë që ne mbetemi mbështetësit dhe avokatët tuaj të patundur.

Kjo vlen edhe për krizën aktuale të migrimit dhe të refugjatëve po ashtu. Shtetet e Grupit të Vishegradit kanë kërkuar fuqishëm që rrugës tranzitore të Ballkanit Perëndimor si edhe nevojës për veprim kolektiv evropian t'i kushtohet vëmendje e posaçme që nga fillimi i krizës së migrimit. Disa prej shteteve më të prekura të Ballkanit Perëndimor ju është ofruar tashmë një Vishegrad i përbashkët si edhe ndihmë e dyanshme.

Ju sigurojmë që krizat me të cilat po përballon BE aktualisht, prej të cilave më sfiduesja është ajo e migrimit dhe e refugjatëve, nuk do të jenë shkak për hezitim nga ana jonë në lidhje me mbështetjen tonë për zgjerimin e mëtejshëm të BE-së. Ky proces drejtohet me rregulla të qarta dhe lidhja e tij me krizën e migrimit do ta dëmtonte të ardhmen e tij si edhe atë të idesë evropiane. Ne besojmë që të

gjitha palët do të përfitojnë nga hyrja e shteteve të Ballkanit Perëndimor në Union dhe do të përpiqemi të sigurojmë që veprimet e Unionit drejtohen nga kjo.